

Shënim: Ndryshimet që propozohen nga EURALIUS dhe OPDAT bazohen (1) në përmbushjen e opinioneve të Komisionit të Venecias, në veçanti në opinionin përfundimtar të datës 15 mars 2016 (nr. 824/2015); (2) në vendimet politike të marra nga Komisioni i Posaçëm i Reformës në Drejtësi; (3) në marrjen në konsideratë të shqetësimeve politike që lidhen me disa institucione të veçanta dhe në ofrimin e opsioneve (shënuar me ngjyrë blu); (4) në synimin për të harmonizuar tekstin, ose kryerjen e ndërhyrjeve teknike në Projektligj që rrjedhin drejtpërsëdrejti nga reflektimi i propozimeve/rekomandimeve të Komisionit të Venecias. Këto propozime nuk përfshijnë ndonjë vendimmarrje politike që nuk është arritur ende dhe as nuk kanë për synim të kërkojnë përzgjedhjen/favorizimin e një vendimi politik kundrejt një tjetri.

Ndryshimet në tekst janë me ngjyrë të kuqe. Pjesa tjetër e tekstit me ngjyrë të zezë është teksti që i është dërguar Komisionit të Venecias më 15 janar 2016.

PROJEKTLIGJ

Nr. ___/___/2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998,
"KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 83, pika 1, dhe 177 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

PJESA E PARË PARIME THEMELORE

Neni 1

Në preambulën e Kushtetutës, pas fjalëve “me bindjen e thellë se” shtohen fjalët “vlerat evropiane”.

Neni 2

Në nenin 2, pas paragrafit të tretë, shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje:

Republika e Shqipërisë, pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, i delegon institucioneve të tij pushtete të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi, në bazë të një ligji të miratuar me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 3

Në nenin 6/1 pas fjalës “ndalohet” shtohen fjalët “për një kohëzgjatje të caktuar”

Ndalohet për një kohëzgjatje të caktuar¹ zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që çenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 4

Neni 12, pika 3 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

Forcat e huaja ushtarake mund të vendosen dhe të kalojnë në territorin shqiptar, si dhe forcat ushtarake shqiptare mund të dërgohen jashtë, sipas procedurës së parashikuar me ligj të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje ndërkombëtare.

¹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 74

Neni 5

Neni 18, pika 2 ndryshon si vijon:

Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, identiteti gjinor, orientimi seksual, gjendja ekonomike, pasurore, arsimore, origjina sociale, lindja, aftësia e kufizuar, përkatësia shoqërore, prindërore ose të tjera.

Neni 6

Neni 39, pika 2, ndryshon si vijon:

Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, me vendim gjyqësor, si dhe kur parashikohet në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Neni 7

Neni 43 ndryshon si vijon:

Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj **për çështjet civile dhe administrative me vlerë të pakët ose të rëndësishme të vogël.**²

Neni 8

Në nenin 54 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“Interesi më i lartë i fëmijëve zbatohet në të gjitha çështjet që lidhen me ta.”

Neni 9

Në nenin 64 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“Shtetasit shqiptarë, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Parlamentin Evropian, sipas procedurës së parashikuar në ligj.”

² Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 76

Neni 10

Në nenin 73, në pikën tre, fjalia e dytë pas fjalëve 'Në këto raste' shtohet 'Drejtuesi i Prokurorisë Posaçme ose'

3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Në këto raste, **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ose**³ Prokurori i Përgjithshëm njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës.

Neni 11

Pas nenit 80 shtohet neni 80/a me këtë përmbajtje:

Neni 80/a

Këshilli i Ministrave i raporton Kuvendit të Shqipërisë për aktet e hartuara në kuadër të pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në institucionet e Bashkimit Evropian. Kuvendi mund të nxjerrë rezoluta që shërbejnë si bazë për veprimet e Këshillit të Ministrave në institucionet e Bashkimit Evropian.

Neni 12

Në nenin 109, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur u njihet edhe shtetasve të Bashkimit Evropian, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 13

Neni 122, pika 3 dhe 4 ndryshohet si më poshtë:

3. E drejta e Bashkimit Evropian që zbatohet drejtpërsëdrejti ka epërsi mbi të drejtën e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

4. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

³ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 shënimi 9; Ndryshim teknik që lidhet me ndryshimin në Nenin 148/3.

PJESA E TETË GJYKATA KUSHTETUESE

Neni 14

Neni 124 ndryshon si më poshtë vijon:

Neni 124

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.
3. Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë që e administron në mënyrë të pavarur.

Neni 15

Neni 125 ndryshon si më poshtë vijon:

Neni 125

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, tre prej të cilëve emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë emërohen nga Kuvendi dhe tre anëtarë emërohen nga mbledhja e përbashkët e Gjykatës së Lartë dhe e Gjykatës së Lartë Administrative⁴. Anëtarët që emërohen nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi përzgjidhen nga lista e kandidatëve të hartuar **dhe renditur** nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese garanton standardet e kandidimit të hapur, konkurimit të ndershëm, transparencës dhe përzgjedhjes së kandidatëve më të kualifikuar.
2. **Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Kur në votimin e parë Kuvendi nuk siguron shumicën e kërkuar prej tre të pestave, brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës së kandidatëve, kandidati i renditur më lart konsiderohet i emëruar⁵.**
3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet⁶, pa të drejtë riemërimi dhe përzgjidhen nga radhët e juristëve me të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

⁴ Opsion politik sipas Opinionit të Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 38 mund të kërkohej përfshirja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi edhe për përzgjedhjen e 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese që vijnë nga gjyqësori. Vendimmarrja për përfshirjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për sa i përket kësaj procedure të emërimit duhet të marrë në konsideratë përbërjen e tij.

⁵ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 37.

⁶ Opsion politik sipas Opinionit Final të Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 39; "12 vjet", megjithatë zëvendësim/rotacion më i shpeshtë është një mjet për të luftuar korrupsionin.

4. Kandidatët nuk duhet të jenë dënuar për kryerjen e një vepre penale. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe pozicione drejtuese në një parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Ligji parashikon kriteret të hollësishme dhe procedurën për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

5. Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese duhet të udhëhiqet nga parimi i përtëritjes çdo 3 vjet në një të tretën e saj, sipas procedurës së caktuar me ligj.

6. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë me shumicën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për një periudhë 3 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje. Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk merr në votimin e parë shumicën e kërkuar, zhvillohet një votim i dytë për dy kandidatët të cilët kanë marrë më shumë vota. Në rast se pas votimit të dytë, asnjë prej kandidatëve nuk merr shumicën e kërkuar të votave, atëherë përzgjidhet kandidati me më shumë vota. Në rast të barazisë së votave, Kryetari zgjidhet me short. Ligji parashikon kriteret dhe procedura e hollësishme⁷ për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

7. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 127, paragrafi 1 nëparagrafi c), ç), d), dh) dhe e)⁸.

Neni 16

Neni 126 ndryshon si më poshtë vijon:

Neni 126

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi të paligjshëm si pasojë e një sjellje kriminale, interesi personal ose keqdashje.

Neni 17

Neni 127 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 127

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron në rastet e mëposhtme:
 - a) mbush moshën 70 vjeç;
 - b) përfundon mandatin 9 vjeçar;

⁷ Mekanizëm zhbllokues që merr në konsideratë Opinionin Final të Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 22.

⁸ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 77; I njëjti ndryshim është bërë në Nenin 136 paragrafi 7 në mënyrë që të harmonizohen/njehsohen dispozitat.

- c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128;
 - d) në zbatim të procedurave të parashikuara në nenin 179/b;
 - dh) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - e) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.
3. Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, **organi përkatës sipas nenit 179, paragrafi 1⁹**, emëron një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.
4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, sipas paragrafit 1 nënparagrafi a) dhe b) si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka deklaruar përfundimin e mandatit.

Neni 18

Neni 128 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 128

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore sipas procedurës që rregullohet me ligj. Procesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, **pa pjesëmarrjen e gjyqtarit subjekt i procedurës disiplinore¹⁰**, e cila vendos për shkarkimin e tij kur:
- a) konstaton shkelje të rënda profesionale **ose¹¹** etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit;
 - b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
2. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra me vendim të Gjykatës Kushtetuese kur:
- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

⁹ Korrëgjim teknik që lidhet me riformulimin e Nenit 179 paragrafi 1.

¹⁰ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 40.

¹¹ Sugjerohet korrëgjim teknik. Qartësisht gjyqtari mund të shkarkohet ose kur ka shkelje të rënda profesionale ose kur ka shkelje të rënda etike. Formulimi i mëparshëm krijonte përshtypjen që gjyqtari duhet të kryente të dyja shkeljet. Ky sugjerim vlen gjithashtu edhe për Nenet 140, 147/c, 147/e, dhe 148/ç.

Neni 19

Neni 130 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 130

Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, **shkencor dhe artistik**¹². Kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme, si dhe masa e shpërblimit parashikohen me ligj. Ushtrimit i funksionit të gjyqtarit nuk pajtohet me qenien anëtar në një parti politike apo pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike, si dhe me veprimtari të tjera të papajtueshme me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 20

Në nenin 131, ndryshohet shkronja f, si më poshtë vijon:

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër vendimeve gjyqësore dhe akteve të pushtetit publik që çenojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Neni 21

Në nenin 131, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 2 me këtë përmbajtje:

2. Gjykata Kushtetuese nuk mund të shpallë antikushtetues një ligj të miratuar nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës, me përjashtim të rastit kur është shkelur procedura e miratimit të këtij ligji.

Neni 22

Neni 132 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 132

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

¹² Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 78; Të njëtat ndryshime janë kryer edhe në Nenet 143, 147/ç, 147/ë, dhe 148/d me qëllim harmonizimin e dispozitave kushtetuese.

2.Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të aktit të shfuqizuar prej saj ndaj kërkuesit në çështjen gjyqësore deri në kohën kur vendimi fillon efektet.

3.Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.

Neni 23

Neni 133, pika 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

2.Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj.

Neni 24

Neni 134 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 134

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:

- a) Presidentit të Republikës;
- b) Kryeministrit;
- c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;
- ç) Avokatit të Popullit;
- d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;
- e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;
- ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- f) organeve të qeverisjes vendore;
- g) organeve të bashkësive fetare;
- gj) partive politike;
- h) organizatave;
- i) individëve.

2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët d, dh, e, ë, f, g, gj, h, dhe i të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

PJESA E NËNTË

GJYKATAT

Neni 25

Neni 135 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 135

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Lartë Administrative si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.
3. Gjykata e posaçme e shkallës së parë dhe e apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë, krijohet me ligj. Funksionarë të lartë përfshijnë Presidentin në detyrë dhe ish Presidentët e Republikës, Kryetarin në detyrë dhe ish Kryetarët e Kuvendit, Kryeministrin në detyrë dhe ish Kryeministrat, anëtarët e Këshillit të Ministrave në detyrë, anëtarët e Këshillit të Ministrave gjatë tre viteve të fundit, Prokurorin e Përgjithshëm, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Kryetarët e Bashkive dhe deputetët e Kuvendit, zëvendësministrat, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative, dhe drejtuesit e institucioneve shtetërore qëndrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj.¹³
4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në përputhje me këtë dispozitë dhe ligjin. Kryetari i gjykatës dhe gjyqtarët e këtyre gjykatave shkarkohen përpara përfundimit të mandatit në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore me dy të tretat e votave të Këshillit të Lartë Gjyqësor¹⁴. Gjyqtarët dhe administrata gjyqësore u nënshtrohen me sukses verifikimit të pasurisë dhe të figurës. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund të emërojë asnjë gjyqtar pa marrë pëlqimin e tij dhe familjarëve të afërt për kontrollet periodike të llogarive bankare dhe telekomunikimeve personale, sipas ligjit. Telekomunikimet personale të familjarëve të afërt¹⁵ të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin, do monitorohen vetëm me vendim gjykate.

¹³ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 50. Komisioni i Venecias vuri në dukje që sipas Nenit 90 paragrafi 2 të Kushtetutës, Presidenti mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Megjithatë, Presidenti nuk gëzon imunitet Kushtetues nga ndjekja penale. Procedura e "impeachment" nënkupton shkarkim nga detyra, por kjo nuk do të thotë që ai nuk mund të hetohet penalisht dhe të gjykohet nga një gjykatë përpara se të shkarkohet. Kjo nuk përbën imunitet funksional. Logjikisht, Presidenti duhet të jetë subjekt i ndjekjes penale dhe gjykimit nga një gjykatë, si një procedurë e ndarë nga ajo e shkarkimit/"impeachment".

¹⁴ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 48. Gjithashtu kjo reflekton marrëveshjen politike të datës 23 mars 2016.

¹⁵ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 51.

Neni 26

Neni 136 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 136

1. Anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9 vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Presidenti i Republikës brenda 7 ditëve nga dërgimi i propozimit prej Këshillit të Lartë Gjyqësor emëron anëtarin e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative.
2. Presidenti i Republikës ka të drejtë të mospranojë propozimin e bërë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor vetëm një herë me dekret të arsyetuar, **bazuar në shkaqe që lidhen me mosplotësimin e kriterëve të kualifikimit ose në kushtet e pazgjedhshmërisë të kandidatit të parashikuara në Kushtetutë ose në ligj.**¹⁶ Dekreti i Presidentit të Republikës për mospranimin e propozimit të paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor humbet efektin kur shumica e anëtarëve të tij votojnë kundër dekretit. Në këtë rast si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati konsiderohet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 7 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Anëtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë. Një e pesta e anëtarëve të tyre mund të zgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Anëtarët jo gjyqtarë duhet të kenë arsim të lartë juridik dhe gradë shkencore në drejtësi.
4. Anëtarët jo gjyqtarë nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.
5. Kriteret dhe procedura e përzgjedhjes dhe të emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative, si dhe kushtet për vazhdimësinë e ushtrimit të detyrës parashikohen me ligj.
6. Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative zgjidhen me shumicën e anëtarëve të secilës gjykatë, me votim të fshehtë, për një periudhë 3 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje. **Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk merr në votimin e parë shumicën e kërkuar, zhvillohet një votim i dytë për dy kandidatët të cilët kanë marrë më shumë vota. Në rast se pas votimit të dytë, asnjë prej kandidatëve nuk merr shumicën e kërkuar të votave, atëherë përzgjidhet kandidati me më shumë vota. Në rast të barazisë së votave, Kryetari zgjidhet me short. Ligji parashikon kriteret dhe procedurat e hollësishme për zgjedhjen e tij**¹⁷.
7. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë ose i Gjykatës së Lartë Administrative, qëndron në

¹⁶ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 26.

¹⁷ Komisioni i Venecias nënvizoi rëndësinë e përfshirjes së një mekanizemi zhblllokues. Opinioni Final i Komisionit të Venecias 825/2015 paragrafi 22 dhe shënimi 4. E njëjta logjikë zbatohet edhe për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative.

detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 139 paragrafi 1, nënparagrafi c), ç), d), dh) dhe e).

Neni 27

Pas nenit 136, shtohet neni 136/a me këtë përmbajtje:

Neni 136/a

Gjyqtarë mund të jenë vetëm shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. Kandidatët përzgjidhen sipas një procedure transparente dhe publike që siguron emërimin e kandidatëve më të kualifikuar dhe me integritet moral dhe etik. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.

Neni 28

Neni 137 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 137

Gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi të paligjshëm si pasojë e një sjellje kriminale, interesi personal ose keqdashje.

Neni 29

Pas nenit 137, shtohet neni 137/a me këtë përmbajtje:

Neni 137/a

1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore sipas procedurave të rregulluara me ligj. Gjyqtari nuk mund të largohet nga detyra përveç rasteve kur:

- a) mbush moshën e pensionit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) vërtetohen **kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit**¹⁸;

¹⁸ Sugjerim për ndryshim të paragrafëve c) dhe d) në mënyrë që të harmonizohet me formulimin e Nenit 127 prg.1, gërma dh), e) dhe Neni 139. Përndryshe kjo mund të çojë në interpretime të ndryshme të arsyeve të përfundimit të mandatit të zyrtarëve. Ky sugjerim është bërë gjithashtu në Nenet 147/b, 147/dh, 148, 148/c dhe 149/b.

- ç) shkarkohet për shkelje të rënda profesionale ose etike në përfundim të një procedure disiplinore, ose pas dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;
- dh) në zbatim procedurave të parashikuara në nenin 179/b.

Neni 30

Neni 138 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 138

Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen përveç rasteve kur:

- a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të eliminuar situata të vështira ekonomike të vendit apo emergjenca të tjera kombëtare;
- b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit;
- c) i jepet një masë disiplinore;
- ç) vlerësohet profesionalisht nën mesataren etike ose profesionale¹⁹ sipas ligjit.

Neni 31

Neni 139 ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative mbaron në rastet e mëposhtme:

- a) mbush moshën 70 vjeç;
- b) përfundon mandatin 9 vjeçar;
- c) jep dorëheqjen;
- ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140;
- d) në zbatim të procedurave të parashikuara në nenin 179/b.
- dh) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
- e) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative deklarohet përkatësisht me vendim të Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative. Procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë ose i Gjykatës së Lartë Administrative, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari, sipas paragrafit 1 nënparagrafët a) dhe b), si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara

¹⁹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 79.

afatit ligjor, njofton Këshillin e Lartë Gjyqësor për vendin vakant. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i deklarimit të përfundimit të mandatit.

Neni 32

Nenit 140 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 140

1. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës së Lartë Administrative mban përgjegjësi disiplinore, sipas procedurës që rregullohet me ligj. Gjyqtari shkarkohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:
 - a) konstaton shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të mandatit;
 - b) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës së Lartë Administrative pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

Neni 33

Neni 141 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 141

1. Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative shqyrtojnë çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit dhe sigurojnë njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore²⁰.
2. Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative **zgjidhin mosmarrëveshjet e natyrës juridiksionale në kolegji të përbashkët të të dy gjykatave, që vendos për interpretimin e detyrueshëm të ligjit²¹.**
3. Ligji parashikon procedurat e hollësishme²².

²⁰ Sugjerohet korigjim teknik. Formulimi i Nenit 141 paragrafi 1 nënkuton që GJL ose GJLA të vendosin për çështjet e ligjit, zbatimit të ligjit ose unifikimin e praktikës gjyqësore. Në projekt-strategji është përmenduar synimi për të ulur volumin e punës së GJL në mënyrë që ajo të përqendrohet në çështje të ligjit për unifikimin e praktikës në Shqipëri. Sa më sipër mbështetet edhe nga Opinioni i Komisionit të Venecias CDL-AD(2014)016, paragrafi 37. Sugjerohet që formulimi të ndryshojë si vijon “Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Lartë Administrative shqyrtojnë çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.”

²¹ Opinioni Final të Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 43.

²² Ndryshim që lidhet me ndryshimet e paragrafit 2 të këtij Neni sipas Komisionit të Venecias. Rregullimet në ligj nuk duhet të lidhen vetëm me paragrafin 2, por duhet të përfshijnë të dy paragrafët e këtij Neni.

Neni 34

Neni 143 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 143

Qenia gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe i Gjykatës së Lartë Administrative nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, **shkencor dhe artistik**. Kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme, si dhe masa e shpërblimit parashikohen me ligj. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit nuk pajtohet me qenien anëtar në një parti politike apo pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike, si dhe me veprimtari të tjera të papajtueshme me detyrën e gjyqtarit, sipas ligjit.

Neni 35

Neni 147 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 147

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi nga radhët e juristëve jo gjyqtarë.
3. **Anëtarët gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e gjyqtarëve me moral dhe integritet të lartë profesional sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve të cilët vijnë nga radhët e gjyqësorit rregullohen me ligj²³. Anëtarët jo gjyqtarë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me moral dhe integritet të lartë profesional. Kandidatët nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.**
4. Anëtarët jo gjyqtarë zgjidhen me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit mbi bazën e propozimeve, nga radhët e avokatëve, një anëtar, nga radhët e noterëve, një anëtar, nga trupa e pedagogëve të drejtësisë, një anëtar, nga trupa e pedagogëve jo gjyqtarë ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës, një anëtar, dhe

²³ Reformulim duke patur parasysh Opinionin Final të Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 18. Hequr formulimi: "Kriteret dhe procedura transparente dhe publike e përzgjedhjes dhe e renditjes së kandidatëve gjyqtarë parashikohen me ligj";

nga shoqëria civile, një anëtar. Për çdo vend vakant organizmat propozuese i paraqesin Këshillit të Emërimeve në Drejtësi tre kandidatë të përzgjedhur, sipas një procedure transparente dhe publike. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën renditjen e kandidatëve dhe ia dërgon Kuvendit.

5. Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Kur në votimin e parë Kuvendi nuk arrin shumicën prej tre të pestave, organizmi propozues bën një propozim të ri brenda 15 ditëve. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson dhe rendit kandidatët brenda 7 ditëve nga dorëzimi i propozimeve të reja. Kuvendi voton për kandidaturat e reja brenda 7 ditëve nga dorëzimi i vlerësimit dhe renditjes. Në rast se kjo shumicë nuk arrihet as në votimin e dytë, kandidatët nga të dyja raundet që renditen të parët për secilin grup konsiderohen të emëruar.

6. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo gjyqtarë, me shumicën e të gjithë anëtarëve. Në rast se kryetari nuk zgjidhet në mbledhjen e parë, anëtari më i vjetër në moshë nga radhët e gjyqësorit organizon zgjedhjen e kryetarit me short në mbledhjen e radhës, e cila zhvillohet e hapur. Kryetari qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit anëtarët gjyqtarë rikthehen në vendet e mëparshme të punës²⁴. Anëtarët jo gjyqtarë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barazvlefshme me to.

Neni 36

Pas nenit 147 shtohet neni 147/a, me këtë përmbajtje:

Neni 147/a

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve, duke përfshirë gjyqtarët e gjykatave të posaçme, përveç kur parashikohet ndryshe në Nenin 179/b²⁵. Kjo kompetencë nuk ushtrohet për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;

b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve, duke përfshirë gjyqtarët e gjykatave të posaçme përveç kur parashikohet ndryshe në Nenin 179/b duke respektuar parimet e gjykimit të drejtë²⁶. Kjo kompetencë nuk

²⁴ Sugjerohet ndryshim teknik. Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të cilët janë gjyqtarë të Gjykatës së Lartë ose Gjykatës së Lartë Administrative nuk duhet t'u ndërpritet mandati, sepse ata zgjedhin të shërbejnë në këtë Këshill. Në mënyrë që të parandalohet ndonjë interpretim i mundshëm, sugjerohet shtimi formulimit "Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë ose të Gjykatës së Lartë Administrative i pezullohet mandati për periudhën që ushtron detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor."

²⁵ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 27.

²⁶ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 35.

ushtrohet për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;

c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Lartë Administrative, sipas procedurës së caktuar me ligj;

ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre;

d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave²⁷;

dh) propozon dhe administron buxhetin e saj²⁸ dhe të gjykatave.

e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor;

f) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë dhe vendosë në nën-komisione.²⁹

3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, **pa të drejtë vote³⁰**, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.

Neni 37

Pas nenit 147/a shtohet neni 147/b, me këtë përmbajtje:

Neni 147/b

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor mbaron sipas rasteve të mëposhtme:

a) mbush moshën e pensionit;

b) përfundon mandati 5 vjeçar;

c) jep dorëheqjen;

ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/c;

d) në zbatim të procedurave të parashikuara në nenin 179/b;

dh) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;

e) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 147, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.

²⁷ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 32; Sugjerohet rregullimi i rolit të Ministrit të Drejtësisë. Ky është vendim politik. Një sugjerim është të shtohet si më poshtë në fund të këtij paragrafi “me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, funksion që ushtrohet nga Ministri i Drejtësisë.” Një ndryshim i ngjashëm duhet të bëhet në Nenin 149/a për t’i dhënë Ministrit të Drejtësisë një rol në administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit. Kjo është një praktikë e njohur në shumë vende të BE-së.

²⁸ Sugjerim teknik. Kjo është e nevojshme për të dy Këshillat nga pikëpamja buxhetore/financiare si dhe për të mundësuar që në ligj të parashikohen kompetencat e tjera të nevojshme. Ata (Këshillat) duhet të kenë kompetencë për të kontrolluar buxhetet e tyre. Ky ndryshim i sugjeruar është reflektuar edhe në Nenin 148/b, gërma e) dhe f). Paragrafi i mëparshëm 2) është ndarë në gërmat e) dhe f) të paragrafit 1.

²⁹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 20.

³⁰ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 32.

4. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një anëtari, sipas paragrafit 1 nënparagrafi a) dhe b) si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e anëtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i deklaramit të përfundimit të mandatit.

Neni 38

Pas nenit 147/b shtohet neni 147/c, me këtë përmbajtje:

Neni 147/c

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor mban përgjegjësi disiplinore dhe shkarkohet nga Tribunali Disiplinor i Drejtësisë kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
2. Procedura për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore rregullohen me ligj.

Neni 39

Pas nenit 147/c shtohet neni 147/ç, me këtë përmbajtje:

Neni 147/ç

Qenia anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademik, shkencor dhe artistik. Kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme, si dhe masa e shpërblimit parashikohen me ligj. Ushtrimit i këtij funksioni nuk pajtohet me qenien anëtar në një parti politike apo pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike, si dhe me veprimtari të tjera të papajtueshme me detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit.

Neni 40

Pas nenit 147/ç shtohet neni 147/d, me këtë përmbajtje:

Neni 147/d

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të

Përgjithshëm si dhe **me iniciativën e tij**³¹ për hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj tyre. **Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë**³².

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Kandidatët nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Inspektori i Lartë i Drejtësisë përzgjidhet nga lista e kandidatëve të renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sipas një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej tre të pestave për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari konsiderohet i emëruar.

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Pas përfundimit të mandatit, nëse përpara emërimit në këtë detyrë punonte me kohë të plotë në sektorin publik, Inspektori rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në pamundësi, në një detyrë të barazvlefshme me të.

4. Procedurat për marrjen e vendimeve nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë rregullohen me ligj. Ndaj vendimeve të Inspektorit për mosfillimin dhe pushimin e hetimit mund të ushtrohet ankim, sipas rastit, në Këshillin e Lartë Gjyqësor ose në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Shqyrtimi i këtyre ankesave vendoset nga një numër anëtarësh i këtyre organeve, sipas ligjit.³³

Neni 41

Pas nenit 147/d shtohet neni 147/dh, me këtë përmbajtje:

Neni 147/dh

1. Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbaron sipas rasteve të mëposhtme:
 - a) mbush moshën e pensionit;
 - b) përfundon mandati 9 vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 147/e;
 - d) në zbatim të procedurave të parashikuara në nenin 179/b.
 - dh) **vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;**
 - e) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

³¹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 29-30

³² Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 30

³³ Hequr paragrafi 6: "Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të vendosë mosfillimin ose pushimin e një hetimi kur ai kërkohet nga Ministri i Drejtësisë, përveç rasteve kur kërkesa është haptazi e pabazuar." Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 31-32.

2. Mbarimi i mandatit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë deklarohet me vendim të mbledhjes së përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë deri në emërimin e Inspektorit të ri, **me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 1, gërmat c), ç), d), dh) dhe e).**

3. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit, sipas paragrafit 1 nënparagrafi a) dhe b), si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e Inspektorit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i deklarimit të përfundimit të mandatit.

Neni 42

Pas nenit 147/dh shtohet neni 147/e, me këtë përmbajtje:

Neni 147/e (Opsione të mundshme)

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mban përgjegjësi disiplinore dhe shkarkohet nga Tribunali Disiplinor i Drejtësisë kur:

- a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
- b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

2. Procedura për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore rregullohet me ligj³⁴.

3. ³⁵ Pretendimet lidhur me shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë hetohen nga një deputet i Kuvendit duke respektuar të drejtën e tij për proces të drejtë, sipas ligjit. Deputeti paraqet raportin mbi gjetjet pranë Tribunalit Disiplinor në përputhje me rregullat e parashikuara në ligj. Deputeti i cili kryen hetimin duhet të ketë arsim të lartë juridik dhe zgjidhet me short nga Kryetari i Kuvendit midis anëtarëve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut³⁶.

³⁴ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 33; hequr kompetenca e Ministrit të Drejtësisë të inspektojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

³⁵ Komisioni i Posaçëm diskutoi në lidhje me një komision hetimor parlamentar ose procedure "impeachment" për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Kjo çështje u ngrit kryesisht nga opozita. Kështu propozohet një opsion i mundshëm. Një opsion mund të jetë si vijon: Inspektori mund të hetohet nga "jashtë" sistemit të gjyqësorit, por të drejtat për një proces të rregullt dhe praktika gjyqësore kërkojnë që marrja e masave disiplinore apo shkarkimi të bëhet nga një organ gjyqësor, siç është Tribunali Disiplinor i Drejtësisë. Të tjerë anëtarë të Komisionit të Posaçëm ishin kundër komisionit hetimor parlamentar pasi ai mbart rrezikun e hetimeve të motivuara politikisht. Ekspertët e opozitës ngritën të njëjtin shqetësim përmes komisionit hetimor në fq.19 të letrës të datës 25 prill 2016. Prandaj, pasja e një hetuesi të vetëm i cili duhet të respektojë të drejtën e një procesi të rregullt gjyqësor dhe rregullat e parashikuara në këtë ligj mund të kufizojë në një farë mase rrezikun. Më tej, rezultatet e hetimit i përcillen Tribunalit i cili merr vendim rreth çështjes.

³⁶ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 33. Ky formulim përfshin edhe shqetësimet e ngritura nga Komisioni i Posaçëm në lidhje me korporatizmin, por gjithashtu ul rrezikun që një komision parlamentar të përdoret për të denigruar Inspektorin e Lartë. Zgjedhja e një deputeti i cili ka mbaruar studimet në drejtësi i përzgjedhur me short mënjanon rrezikun që shumica ose opozita të kenë dijeni se kush do të kryejë hetimin.

Neni 43

Pas nenit 147/e shtohet neni 147/ë, me këtë përmbajtje:

Neni 147/ë

Qenia Inspektor i Lartë i Drejtësisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore si dhe profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë mësimdhënëse, akademik, **shkencor dhe artistik**. Kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme, si dhe masa e shpërblimit parashikohen me ligj. Ushtrimi i funksionit të Inspektorit nuk pajtohet me anëtarësinë në një parti politike apo pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike, si dhe me veprimtari të tjera të papajtueshme me detyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas ligjit.

Neni 44

Pas nenit 147/ë shtohet neni 147/f, me këtë përmbajtje:

Neni 147/f (*Opsion i mundshëm*)³⁷

1. Tribunali Disiplinor i Drejtësisë vendos në lidhje me masat disiplinore për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Tribunali Disiplinor i Drejtësisë përbëhet nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, një gjyqtar tjetër nga Gjykata e Lartë i zgjedhur me short, një gjyqtar i Gjykatës së Lartë Administrative i zgjedhur me short, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë nga gjykatat e apelit të zgjedhur me short, dhe një gjyqtar dhe një prokuror nga gjykatat e shkallës së parë të zgjedhur me short. Ligji parashikon procedurën dhe mënyrën e përzgjedhjes me short.
3. Ankimet kundër vendimeve të Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë si dhe ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

³⁷ Teksti dërguar Komisionit të Venecias përfaqëson një opsion të vlefshëm shkencor/akademik. Gjatë mbledhjeve të Komisionit të Posaçëm, opozita ka pranuar vlerën e ekzistencës së Tribunalit, por ka shprehur shqetësime rreth korporatizmit dhe konfliktit të interesave në përbërjen e tij. Ky opsion redukton korporatizmin brenda Tribunalit dhe mund të mënjanojë parashikueshmërinë e anëtarëve të tij. Duke qenë se Komisioni i Venecias dhe Neni 6 i KDENJ kërkojnë që Tribunali të ketë kompetencat e një gjykate, ai nuk mund të ketë në përbërje anëtar jo magjistratë, për sa kohë nuk ka një sistem me juri apo me gjyqtarë jo jurist ("lay-judges). Në faqet 17, 18 të komentëve të opozitës, parashtrohet "favorizimi" i dhënies së Gjykatës së Lartë të rolit të një Tribunali Disiplinor, me të drejtë ankimi në Gjykatën Kushtetuese. Në vende me sisteme të zhvilluara dhe të konsoliduara, është e vërtetë që Gjykata e Lartë mund ta kryejë këtë rol, por ky nuk është një model i përshtatshëm për Shqipërinë. Në fakt, ne nuk arrijmë të kuptojmë se si kjo gjë (propozimi) mund të reduktojë korporatizmin, pasi i jep kompetenca të mëdha një institucioni: Gjykatës së Lartë, për të marrë vendime disiplinore kundër anëtarëve të KLP, KLGJ, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në vend që të ulë korporatizmin, kjo në mënyrë të parashikueshme e rrit atë, pa parashikuar edhe një sistem llogaridhënie.

4. Kryetar i Gjykatës së Lartë është Kryetari i Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë, i cili krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë .

PJESA E DHJETË

PROKURORIA

Neni 45

Neni 148 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 148

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.

2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale. Prokuroria e Posaçme për ndjekjen penale si dhe njësia e posaçme për hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm dhe krijohen me ligj. **Njësia e posaçme hetimore raporton vetëm tek Prokuroria e Posaçme.**

a. Prokuroria e Posaçme ushtron funksionet pranë gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

b. Këshilli i Lartë i Prokurorisë emëron të paktën 10 prokurorë, me mandat 9 vjeçar, në Prokurorinë e Posaçme. Në rast nevojë, ai vendos shtimin e numrit të prokurorëve. Ligji parashikon kriteret dhe procedurat transparente dhe publike për përzgjedhjen e tyre. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet nga rradhët e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me mandat 3 vjeçar, pa të drejtë riemërimi, sipas ligjit. Drejtuesi dhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme shkarkohen përpara përfundimit të mandatit në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore me dy të tretat e votave të Këshillit të Lartë të Prokurorisë³⁸.

c. Drejtuesi dhe prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, oficerët e hetimit dhe punonjësit e administratës u nënshtrohen me sukses verifikimit të pasurisë dhe të figurës. Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk mund të emërojë asnjë Drejtues ose prokuror të Prokurorisë së Posaçme pa marrë pëlqimin e tij dhe familjarëve të afërt për kontrollet periodike të llogarive bankare dhe telekomunikimeve personale, sipas ligjit. Oficerët e hetimit dhe punonjësit e administratës i nënshtrohen gjithashtu kontrollit periodik të llogarive bankare dhe

³⁸ Opinionin Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 48; Gjithashtu kjo reflekton diskutimet politike 23 mars 2016.

telekomunikimeve personale, sipas ligjit. Telekomunikimet personale të atyre të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin, do të monitorohen vetëm me vendim gjykate³⁹.

3. Prokurorë mund të jenë vetëm shtetas shqiptar, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. Kandidatët përzgjidhen sipas një procedure transparente dhe publike që siguron përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar dhe me integritet të lartë moral dhe profesional. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve parashikohen me ligj.

4. Në ushtrimin e kompetencave të tyre prokurorët u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

5. Të gjithë prokurorët mbajnë përgjegjësi disiplinore sipas procedurave të rregulluara me ligj. Prokurori nuk mund të largohet nga detyra përveç rasteve kur:

- a) mbush moshën e pensionit;
- b) jep dorëheqjen;
- c) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
- ç) shkarkohet për shkelje të rënda profesionale ose etike në përfundim të një procedure disiplinore, ose pas dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;
- dh) në zbatim të procedurave të parashikuara në Nenin 179/b⁴⁰.

Neni 46

Pas nenit 148 shtohet neni 148/a, me këtë përmbajtje:

Neni 148/a

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi nga radhët e juristëve jo prokurorë.

3. Anëtarët prokurorë përzgjidhen nga rradhët e prokurorëve me moral dhe integritet të lartë profesional sipas një procedure transparente dhe publike që siguron një përfaqësim të drejtë të të gjitha shkallëve të prokurorisë. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve të cilët vijnë nga rradhët e prokurorisë

³⁹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafët 51 dhe 83.

⁴⁰ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 48;

rregullohen me ligj⁴¹. Anëtarët jo prokurorë përzgjidhen nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional. Kandidatët nuk duhet të jenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale. Ata nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

4. Anëtarët jo prokurorë zgjidhen nga Kuvendi me tre të pestat e të gjithë anëtarëve mbi bazën e propozimeve nga radhët e avokatëve, një anëtar, nga radhët e noterëve, një anëtar, nga trupa e pedagogëve të drejtësisë, një anëtar, nga trupa e pedagogëve jo gjyqtarë ose prokurorë të Shkollës së Magjistraturës, një anëtar dhe nga shoqëria civile, një anëtar. Për çdo vend vakant organizmat propozuese i paraqesin Këshillit të Emërimeve në Drejtësi tre kandidatë të përzgjedhur, sipas një procedure transparente dhe publike. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën renditjen e kandidatëve dhe ia dërgon Kuvendit.

5. Kuvendi voton veçmas për secilin grup kandidatësh. Kur në votimin e parë Kuvendi nuk arrin shumicën prej tre të pestave, organizmi propozues bën një propozim të ri brenda 15 ditëve. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson dhe rendit kandidatët brenda 7 ditëve nga dorëzimi i propozimeve të reja. Kuvendi voton për kandidaturat e reja brenda 7 ditëve nga dorëzimi i vlerësimit dhe renditjes. Në rast se kjo shumicë nuk arrihet as në votimin e dytë, kandidatët nga të dyja raundet, të cilët renditen të parët për secilin grup konsiderohen të emëruar.

6. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jo prokurorë, me shumicën e të gjithë anëtarëve. Në rast se kryetari nuk zgjidhet në mbledhjen e parë, anëtari më i vjetër nga radhët e prokurorisë organizon zgjedhjen e kryetarit me short në mbledhjen e radhës, e cila zhvillohet e hapur. Kryetari qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

7. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej pesë vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje të njëpasnjëshme. Në përfundim të mandatit anëtarët prokurorë rikthehen në vendet e mëparshme të punës. Anëtarët jo prokurorë që përpara emërimit punonin me kohë të plotë në sektorin publik, rikthehen në vendet e mëparshme të punës ose në pamundësi, në detyra të barazvlefshme me to.

Neni 47

Pas nenit 148/a shtohet neni 148/b, me këtë përmbajtje:

Neni 148/b

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

⁴¹ Riformulim duke patur parasysh Opinionin Final të Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 19; Hequr formulimi "Kriteret dhe procedura transparente dhe publike e përzgjedhjes dhe e renditjes së kandidatëve prokurorë parashikohet me ligj".

- a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve, duke përfshirë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, përveç kur parashikohet ndryshe në Nenin 179/b;
 - b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve e të gjitha niveleve duke përfshirë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, përveç kur parashikohet ndryshe në Nenin 179/b, duke respektuar parimet e gjykimit të drejtë⁴²;
 - c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj;
 - ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre;
 - d) propozon dhe administron buxhetin e saj;
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përgatit raporte mbi gjendjen e prokurorisë, informon publikun dhe Kuvendin, si dhe ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të krijojë dhe vendosë në nën-komisione.⁴³

Neni 48

Pas nenit 148/b shtohet neni 148/c, me këtë përmbajtje:

Neni 148/c

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbaron sipas rasteve të mëposhtme:
 - a) mbush moshën e pensionit;
 - b) përfundon mandatin 5 vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimit të nenit 148/ç.
 - d) në zbatim të procedurave të parashikuara në nenin 179/b.
 - dh) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - e) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit të anëtarit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 148/a, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.
4. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një anëtari, sipas paragrafit 1 nënparagrafi a) dhe b) si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e anëtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i deklarimit të përfundimit të mandatit.

⁴² Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 35.

⁴³ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 20.

Neni 49

Pas nenit 148/c, shtohet neni 148/ç, me këtë përmbajtje:

Neni 148/ç

1. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë mban përgjegjësi disiplinore dhe shkarkohet nga Tribunali Disiplinor i Drejtësisë kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
2. Procedura për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore rregullohen me ligj.

Neni 50

Pas nenit 148/ç shtohet neni 148/d, me këtë përmbajtje:

Neni 148/d

Qenia anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor dhe artistik. Kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme, si dhe masa e shpërblimit parashikohen me ligj. Ushtrimi i këtij funksioni nuk pajtohet me qenien anëtar në një parti politike apo pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike, si dhe me veprimtari të tjera të papajtueshme me detyrën e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 51

Neni 149 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 149

1. Prokurori i Përgjithshëm emërohet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. **Bazuar në një thirrje publike për kandidatët, Këshilli i Lartë i Prokurorisë përzgjedh dhe rendit sipas një procedure transparente dhe publike tre kandidatët më të kualifikuar dhe me reputacion më të mirë dhe ia përcjell ata Kuvendit⁴⁴.** Nëse Kuvendi nuk emëron Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur më lart nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë konsiderohet i emëruar. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të Prokurorit të Përgjithshëm parashikohet me ligj.
2. Prokurori i Përgjithshëm emërohet për një periudhë 7 vjeçare pa të drejtë

⁴⁴ Në këtë paragraf është përfshirë Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 24

riemërimi.

3. Prokurori i Përgjithëm emërohet nga rradhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, pas përfundimit të studimeve në Shkollën e Magjistraturës ose me gradë shkencore në drejtësi. Prokurori i Përgjithshëm nuk duhet të ketë qenë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale. Ai nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike dhe pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

Neni 52

Pas nenit 149 shtohet neni 149/a, me këtë përmbajtje:

Neni 149/a

Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

1. përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga prokurorët e prokurorisë së posaçme, sipas nenit 148/3 të Kushtetutës;
2. nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët, me përjashtim të prokurorëve të prokurorisë së posaçme sipas nenit 148/3 të Kushtetutës;
3. siguron mbarëvajtjen e punës në administratën e prokurorisë, me përjashtim të administratës së Prokurorisë së Posaçme sipas nenit 148, paragrafi 3 të Kushtetutës,
4. propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të prokurorisë së posaçme sipas nenit 148/3 të Kushtetutës;
5. raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit;
6. ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në ligj.

Neni 53

Pas nenit 149/a shtohet neni 149/b, me këtë përmbajtje:

Neni 149/b

1. Mandati i Prokurorit të Përgjithshëm mbaron në rastet e mëposhtme:
 - a) mbush moshën 70 vjeç;
 - b) përfundon mandatin 7 vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas procedurës së parashikuar në nenin 149/c;
 - d) në zbatim të procedurave të parashikuara në nenin 179/b;
 - dh) **vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;**
 - e) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Përfundimi i mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Pas përfundimit të mandatit 7 vjeçar dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën që kishte para emërimit ose gjyqtar në gjykatën e apelit.

Neni 54

Pas nenit 149/b shtohet neni 149/c, me këtë përmbajtje:

Neni 149/c

1. Prokurori i Përgjithshëm mban përgjegjësi disiplinore dhe shkarkohet nga Tribunali Disiplinor i Drejtësisë kur:
 - a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike;
 - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
2. Procedura për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore rregullohet me ligj.

Pas Pjesës së dhjetë shtohet Pjesa e dhjetë/1 me këtë përmbajtje:

Neni 55

Pas nenit 149/c shtohet neni 149/ç, me këtë përmbajtje:

Neni 149/ç (Opsion i mundshëm)⁴⁵

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, profesionale dhe morale të kandidatëve jo gjyqtarë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kandidatëve jo prokurorë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese që emërohen nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët. Renditja e kandidatëve nuk është e detyrueshme me përjashtim të rastit kur Kuvendi nuk arrin të emërojë kandidatin⁴⁶.

⁴⁵ Teksti dërguar Komisionit të Venecias përfaqëson një opsion të vlefshëm shkencor/akademik. Ky opsion reflekton ndryshimet që adreson shqetësimin se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka në përbërje pozicione të veçanta (dhe kështu anëtarët e Këshillit janë të parashikueshëm gjatë fazës së tranzicionit). Ky ishte një shqetësim i shprehur nga opozita gjatë mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, konsultimeve dhe komenteve të datës 27 prill 2016. Në faqet 24 -25 të komenteve të opozitës, kritikohet fakti që një grup i vogël elitari kishte shumë kompetenca/pushtet për të renditur kandidatët. Në këtë opsion është parashikuar përzgjedhja rastësore nga rradhët e niveleve të larta të gjyqsorit dhe disa anëtarë nga nivelet e ulta të tij. U konsiderua e nevojshme të zgjerohet shorti edhe për gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ulta. Edhe pse shumë gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ulta kanë eksperience të mirë, përzgjedhja rastësore me short mbart rrezikun e përzgjedhjes së gjyqtarëve ose prokurorëve me pak vite eksperience në këtë Këshill, ç'ka u vlerësua e papërshtatshme.

⁴⁶ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 shënimi 3.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mbledhet sa herë është e nevojshme.
3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga nëntë anëtarë të përzgjedhur me short, nga rradhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore. Ata ushtrojnë detyrën me mandat një vjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik. Presidenti i Republikës përzgjedh me short midis një dhe pesë dhjetorit të çdo viti kalendarik, dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, një gjyqtar të Gjykatës së Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë pranë gjykatave të apelit dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të përzgjedhë deri në datën pesë dhjetor, Kryetari i Kuvendit përzgjedh me short anëtarët përpara datës dhjetë dhjetor të atij viti kalendarik. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.⁴⁷
4. Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është anëtari i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë krijon kushtet e punës për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
5. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rregullohet me ligj.

Neni 56

Në nenin 161, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

3. Në rastin e nënshkrimit të marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian për pranimin e monedhës evropiane, Banka e Shqipërisë tranferon kompetenca në përputhje me parashikimet e kësaj marrëveshjeje.

PJESA E TETËMBËDHJETË

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 57

Neni 179 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 179 (Tekst i ndryshuar nëse nuk pranohen Opsionet)⁴⁸

1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese sipas mandatit të mëparshëm.
2. Anëtari i parë për t'u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti emërohet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga

⁴⁷ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 82.

⁴⁸ Opsioni bazohet në versionin dërguar Komisionit të Venecias me rregullimet që lidhen me rekomandimet e Komisionit të Venecias. Kjo nuk përfshin dispozitat kalimtare të kërkuara nga opsionet e sugjeruara. Nëse ndryshimet janë bërë në pjesë të tjera të këtij projekti, është e domosdoshme që ato të reflektohen edhe në këtë dispozitë.

mbledhja e përbashkët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative. Kjo rradhë përbën skemën për të gjitha emërimet në të ardhmen. Anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit⁴⁹.

3. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Gjykata e Lartë Administrative krijohet në datën 01.01.2020. Emërimet në Gjykatën e Lartë Administrative duhet të garantojnë përtëritjen e pjeshme të saj. Rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e kësaj gjykate parashikohen me ligj.

5. Tribunali Disiplinor i Drejtësisë, deri në datë 31.12.2019, në vend të 3 anëtarëve të Gjykatës së Lartë Administrative do të ketë në përbërje Kryetarin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe një gjyqtar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe një gjyqtar nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallë së parë dhe të apelit, të zgjedhur secili me short nën drejtimin e Kryetarit të Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe dy anëtarë jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandat tre vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjeshme të këtij organi. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit.

7. Gjatë mandatit të tyre nëntë vjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit sipas Nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor mbi të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 128 të këtij ligji⁵⁰.

8. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë prokurorë dhe dy anëtarë jo prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë emërohen fillimisht për një mandat tre vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjeshme të këtij organi.

9. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërtohet, do të funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit sipas Nenit 135, paragrafi 3, brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas këtij ligji⁵¹. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyrë gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata nuk përfundojnë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës ose refuzojnë të japin miratimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve personale si dhe të familjarëve të tyre të afërt. Prokuroria e Posaçme do të krijohet sipas Nenit 148 paragrafi 3, dhe prokurorët do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas këtij ligji. Pas krijimit të kësaj prokurorie, prokuroria për krimet e rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i

⁴⁹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 81.

⁵⁰ Formulimi i mëparshëm i paragrafit 7 është hequr bazuar në Opinion Final të Komisionit të Venecias 824/2015, paragrafi 81; Formulimi i ri lidhet me Nenin 179/b.

⁵¹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 83.

çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet në përputhje me ligjin.

10. Ndryshimet në Nenet 39 paragrafi 2, 64 paragrafi 4, 80/a, 122 paragrafi 3, 161 paragrafi 3, hyjnë në fuqi pas miratimit të ligjit nga Kuvendi që ratifikon marrëveshjen e lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për anëtarësimin.

11. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Periudha kalimtare dhe mënyra e funksionimit të inspektorateve ekzistuese rregullohet me ligj.

12. Gjyqtarët dhe prokurorët që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës qëndrojnë në detyrë dhe janë subjekt i procesit të vlerësimi kalimtar të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas Nenet 179/b.

13. Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përzgjedh me short një anëtar të Gjykatës së Lartë, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë pranë gjykatave të apelit, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe dy gjyqtarë pranë gjykatave administrative. Në rast se Presidenti i Republikës nuk përzgjedh brenda këtij afati, Kryetari i Kuvendit përzgjedh me short brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Të përzgjedhurit ushtrojnë funksionet si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi deri në datën tridhjetë e një dhjetor të vitit kalendarik të hyrjes në fuqi të këtij ligji. Avokati i Popullit ushtron funksionet si vëzhgues në hedhjen e shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen, pa vonesë, procesit të vlerësimi kalimtar të kualifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas Nenet 179/b.

Neni 179 (Opsion i mundshëm)⁵²

1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese sipas mandatit të mëparshëm.

2. Anëtari i parë për t'u zëvendësuar në Gjykatën Kushtetuese emërohet nga Presidenti i Republikës, i dyti emërohet nga Kuvendi dhe i treti emërohet nga mbledhja e përbashkët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës së Lartë Administrative. Kjo rradhë përbën skemën për të gjitha emërimet në të ardhmen. Anëtarët e rinj të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit sipas ligjit⁵³.

3. Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët, të cilëve u mbaron mandati, emërohen sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Gjykata e Lartë Administrative krijohet në datën 01.01.2020. Emërimet në Gjykatën e Lartë Administrative duhet të garantojnë përtëritjen e pjeshme të saj. Rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e kësaj gjykate parashikohen me ligj.

5. Tribunali Disiplinor i Drejtësisë, deri në datë 31.12.2019, në vend të 3 anëtarëve

⁵² Ndryshimet e bëra në dispozitat kalimtare në këtë projekt janë ofruar bazuar në zgjidhjet e propozuara në projekt. Ky opsion nënkupton se opsionet e tjera në këtë dokument janë marrë parasysht. Nëse janë bërë ndryshime në pjesë të tjera të këtij projekti, mund të jetë e nevojshme që të ndryshohet edhe kjo dispozitë.

⁵³ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 40 dhe 81.

të Gjykatës së Lartë Administrative do të ketë në përbërje Kryetarin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe një gjyqtar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe një gjyqtar nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave administrative të shkallë së parë ose të apelit, të zgjedhur secili me short nën drejtimin e Kryetarit të Tribunalit Disiplinor të Drejtësisë.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë gjyqtarë dhe dy anëtarë jo gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohen fillimisht për një mandat tre vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjeshme të këtij organi. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e përfundojnë mandatin e tyre pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo më vonë se zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas ligjit.

7. Gjatë mandatit të tyre nëntë vjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit sipas Nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor mbi të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese sipas Nenit 128 të këtij ligji⁵⁴.

8. Këshilli i Lartë i Prokurorisë krijohet brenda tetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Tre anëtarë prokurorë dhe dy anëtarë jo prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë emërohen fillimisht për një mandat tre vjeçar, me qëllim përtëritjen e pjeshme të këtij organi.

9. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda do të emërtohet, do të funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit sipas Nenit 135 paragrafi 3, brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas këtij ligji⁵⁵. Transferimi i çështjeve do të bëhet në përputhje me ligjin. Gjyqtarët në detyrë pranë këtyre gjykatave do të transferohen në gjykata të tjera, në rast se ata nuk përfundojnë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës ose refuzojnë të japin miratimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe telekomunikimeve personale si dhe të familjarëve të tyre të afërt. Prokuroria e Posaçme do të krijohet sipas Nenit 148 paragrafi 3, dhe prokurorët do të emërohen brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas këtij ligji. Pas krijimit të kësaj prokurorie, prokuroria për krimet e rënda do të pushojë së funksionuari. Transferimi i çështjeve në hetim dhe gjykim do të kryhet në përputhje me ligjin.

10. Ndryshimet në Nenet 39 paragrafi 2, 64 paragrafi 4, 80/a, 122 paragrafi 3, 161 paragrafi 3 hyjnë në fuqi pas miratimit të ligjit nga Kuvendi që ratifikon marrëveshjen e lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për anëtarësimin.

11. Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Periudha kalimtare dhe mënyra e funksionimit të inspektorateve ekzistuese rregullohet me ligj.

12. Gjyqtarët dhe prokurorët që nuk kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës qëndrojnë në detyrë dhe janë subjekt i procesit të vlerësimi kalimtar të kualifikimit sipas Nenit 179/b.

13. Presidenti i Republikës, brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji,

⁵⁴ Formulimi i mëparshëm i paragrafit 7 është hequr bazuar në Opinion Final të Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 81; Formulimi i ri lidhet me Nenin 179/b.

⁵⁵ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 83.

përzgjedh me short dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, një gjyqtar të Gjykatës së Lartë, një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dy gjyqtarë dhe dy prokurorë pranë gjykatave të apelit dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative. Nëse Presidenti i Republikës nuk përzgjedh brenda pesë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryetari i Kuvendit përzgjedh me short anëtarët përpara dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen, pa vonesë, procesit të vlerësimit kalimtar të kualifikimit për gjyqtarë dhe prokurorë sipas Nenit 179/b.

Neni 58

Pas nenit 179/a shtohet neni 179/b me këtë përmbajtje:

Neni 179/b

1. Bazuar në dispozitat e Aneksit me titull “Vlerësimi Kalimtar i Kualifikimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, **ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative si dhe ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme⁵⁶**, rivlerësohen *ex officio* në mënyrë që të rivendoset funksionimi i duhur i shtetit të së drejtës dhe pavarësia e vërtetë e sistemit të drejtësisë, si dhe besimi i publikut në këto institucione. Rivlerësimi do të kryhet duke respektuar të drejtat e subjektit të vlerësimit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor⁵⁷. Ish gjyqtarët ose ish prokurorët dhe **ish këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët kanë të paktën tre vjet përvojë pune⁵⁸ në këto funksione, mund t'i nënshtrohen** me kërkesë të tyre procesit të rivlerësimit nëse plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj.

2. Subjektet e parashikuara në paragrafin 1, fjalja 1 e këtij Neni, që përfundojnë me sukses procesin e rivlerësimit **vazhdojnë të qëndrojnë** gjyqtarë dhe prokurorë të

⁵⁶ Rekomandim i Komisionit të BE-së.

⁵⁷ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 52 dhe 62.

⁵⁸ Neni 170 i projekt ligjit për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit parashikon:

1. Personat të cilët janë diplomuar, dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për 3 vjet, ose kanë ushtruar funksionin e magjistratët për 10 vjet, 20 vitet e fundit, dhe që:
 - a) Nuk janë shkarkuar për shkelje disiplinore ose kryerjen e veprave penale;
 - b) Nuk kanë qenë anëtar të partive politike ose deputet ose të kenë mbajtur ndonjë pozicion politik në administratën publike ose në një parti politike, ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga hyrja në fuqi të këtij ligji
 - c) nuk kanë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose të favorizuar nga Sigurimi i shtetit para vitit 1990; dhe
 - d) nuk kanë qenë bashkëpunëtor, informator, agjentë të asnjë shërbimi sekret.
- kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e ri-vlerësimit dhe pas përfundimit të suksesshëm të kësaj procedure konsiderohen si të ricaktuar magjistratë me të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e lëvizjeve paralele dhe ngritjes në detyrë për magjistratët ose të aplikojnë për pozicione që mund të ushtrohen vetëm nga magjistratët, jo më vonë se 5 vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

emëruar. Ndhmësit ligjor pranë gjykatave administrative dhe subjektet e përmendura në paragrafin 1, fjalia 3 të këtij Neni, të cilët kalojnë rivlerësimin, kryejnë provimin e pranimit dhe ndjekin programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës sipas parashikimeve të ligjit. Pas përfundimit me sukses të trajnimit, ata emërohen gjyqtarë ose prokurorë.

3. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe ankimet shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit pranë Gjykatës Kushtetuese⁵⁹.

4. Procedura e rivlerësimit do të kryhet pa vonesë dhe sa më me efikasitet që të jetë e mundur, duke garantuar në të njëjtën kohë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore për aq sa janë të zbatueshme në kuadër të rivlerësimit, procesit të rregullt ligjor, parimit të proporcionalitetit dhe të drejtës së ankimit⁶⁰. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe Prokurori i Përgjithshëm vlerësohen me prioritet.

5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioneri Publik pushojnë së funksionuari pas pesë vitesh. Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit pushon së funksionuari pas nëntë vitesh. Pas shpërbërjes së Komisionit, çështjet e papërfunduara do të shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me të njëjtën procedurë si për shkeljet disiplinore. Çështjet e papërfunduara të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me të njëjtën procedurë si për shkeljet disiplinore. Çdo ankim shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese⁶¹. Pas shpërbërjes së Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre do të ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme përgjegjës për korrupsionin dhe krimin e organizuar⁶². Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit do të qëndrojnë në detyrë deri në përfundim të mandatit të tyre nëntë vjeçar⁶³.

6. Kuvendi do të votojë për shfuqizimin e Aneksit në rastin kur vendimi i fundit në procesin e rivlerësimit ka marrë formë të prerë, bazuar në raportin e paraqitur nga Kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit për gjendjen e çështjeve të papërfunduara⁶⁴ ose kur ka përfunduar mandati i Kolegjit të Posaçëm i Kualifikimit⁶⁵.

7. Procedurat e hollësishme rregullohen me ligj.

⁵⁹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 66. Opinion i ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 117.

⁶⁰ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 57 dhe 66.

⁶¹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 56.

⁶² Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 54-56.

⁶³ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 64.

⁶⁴ Rekomandim i Komisionit të BE-së.

⁶⁵ Opinioni i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias, paragrafi 102.

Aneks

Vlerësimi Kalimtar i Kualifikimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve⁶⁶

Neni A

Masa për të Fituar Besimin e Publikut

1. Me qëllim që të garantohen në mënyrë të barabartë të drejtat e shtetasve të Republikës së Shqipërisë për t'iu drejtuar gjykatave dhe për të patur një proces të rregullt ligjor; me qëllim që veprat penale të ndiqen bazuar në elementët e procesit të rregullt ligjor si dhe nisur nga shqetësimet e bazuara se këto të drejta mohohen nga ekzistenca e korrupsionit në sistemin e drejtësisë, ndikimet e elementëve kriminalë dhe niveli i ulët profesional i një pjese të gjyqtarëve ose prokurorëve, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, duke përfshirë nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës dhe nenet e tjera 128, 131 shkronja f), 135, 138, 140, 145 paragrafi 1, 147/a paragrafi 1 shkronja b); 148/b paragrafi 1, shkronja b); kufizohen **pjesërisht sipas nenit 17 të kësaj Kushtetute. Kufizimet bëhen vetëm në masën e nevojshme. Të gjithë subjektet e përmendur në nenin 179/b paragrafi 1 të Kushtetutës rivlerësohen, pavarësisht rasteve të transferimeve ose lejeve të përkohshme nga ushtrimi i detyrave që ata mbajnë.**⁶⁷

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit funksionojnë dhe vendosin në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, sipas dispozitave të këtij Aneksi dhe të ligjit të posaçëm. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit, si dhe procedurat e rivlerësimit të kualifikimit rregullohen me ligj.

3. Pas përfundimit të rivlerësimit të subjekteve të parashikuara **në nenin 179/b paragrafi 1 të Kushtetutes**, sipas parashikimeve të këtij Aneksi, ata i nënshtrohen sistemit të përhershëm të llogaridhënies, sipas rregullave të përgjithshme të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligj.⁶⁸

Neni B

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit⁶⁹

1. **Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, udhëhiqet nga Komisioni Evropian dhe krijohet me qëllim mbështetjen e procesit të rivlerësimit, në bashkëpunim me partnerët, në kuadrin e integritit evropian dhe bashkëpunimit euro-atlantik. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit është përgjegjës për monitorimin dhe**

⁶⁶ Bazuar në sugjerimin e Komisionit të Venecias (opinionin i ndërmjetëm të Komisionit të Venecias paragrafi 101) shumë parashikime janë hequr nga dispozitat kushtetuese dhe janë parashikuar në ligj.

⁶⁷ Opinionin i Ndërmjetëm të Komisionit të Venecias 104 dhe 106.

⁶⁸ Opinionin i Ndërmjetëm të Komisionit të Venecias 102.

⁶⁹ Riformulim i dispozitës bazuar në Opinionin final të Komisionit të Venecias paragrafi 71 dhe 72, si dhe kërkesës së Komisionit të BE-së.

mbikqyrjen e të gjithë procesit të rivlerësimit. Në veçanti, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit emëron vëzhguesit ndërkombëtarë pasi njofton Këshillin e Ministrave⁷⁰.

2. Organizimi dhe funksionimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit rregullohet sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi. Kompetencat e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit rregullohen nga ky aneks dhe nga ligji.⁷¹

3. Vëzhguesi ndërkombëtar janë anëtarë, me jo më pak se 15 vjet eksperiencë si gjyqtar apo prokuror⁷² në sistemin e drejtësisë së vendeve të tyre përkatëse.⁷³ Mandati i vëzhguesit ndërkombëtar ndërpritet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit për shkelje të rënda.

4. Vëzhguesi ndërkombëtarë ushtron këto detyra dhe kompetenca⁷⁴:

a) marrin menjëherë të gjithë informacionet, të dhëna për persona dhe dokumente të nevojshme, me qëllim monitorimin e procesit të rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe shkallët.

b) japin rekomandime për Avokatin e Popullit lidhur me kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionit e anëtarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik⁷⁵.

c) paraqesin gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe nga Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit dhe në veçanti kontribuojnë për kontrollin e figurës sipas nenit DH. Lidhur me këto gjetje, vëzhguesit ndërkombëtarë mund të kërkojnë që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit të marrë në shqyrtim prova ose të paraqesë prova të marra nga organet shtetërore, entitetet e huaja ose personat privatë, sipas ligjit.⁷⁶

d) japin Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se ky i fundit, vendos të mos e ndjekë (respektojë) këtë rekomandim, atëherë Komisioneri Publik duhe të lëshojë një justifikim me shkrim.

Neni C

Dispozita të përgjithshme për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit përbëhet nga katër trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili që shërbëjnë si shkallë e parë, të cilët emërohen në përputhje me këtë Aneks.

2. Dy Komisionerë Publikë përfaqësojnë interesin publik dhe kanë të drejtë të

⁷⁰ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 69 është ndryshuar pak në vijim të kërkesës së Komisionit të BE-së.

⁷¹ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias 130.

⁷² Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 70

⁷³ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias 133.

⁷⁴ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias 134.

⁷⁵ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 61, shënimi 16.

⁷⁶ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias 133 dhe 134.

paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit⁷⁷.

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për ngritjen e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.⁷⁸, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj⁷⁹. Gjyqtarëve të emëruar në Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe nuk iu mbaron mandati me mbushjen e moshës së pensionit, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj.

4. Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë si dhe punonjësit e tjerë të këtyre organeve sipas ligjit nënshkruajnë deklaratë me shkrim me të cilën autorizojnë kryerjen e kontrollit vjetor të pasurisë së tyre, monitorimit sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare dhe heqjen dorë nga e drejta e fshehtësisë së komunikimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në detyrë. Deklaratat e pasurisë së tyre bëhen publike.

5. Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit duhet të kenë arsim të lartë juridik dhe jo më pak se 15 vjet përvojë si gjyqtar, prokuror, lektor i së drejtës, avokat, noter, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose profesione të tjera ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë. Kandidatët për anëtarë të Komisionit dhe gjyqtarë të Kolegjit nuk duhet të kenë qenë gjyqtarë, prokurorë ose këshilltarë/ndihmës ligjorë gjatë dy vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kandidatët nuk duhet të jetë dënuar më parë për kryerjen e një vepre penale, nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike⁸⁰ dhe funksione drejtuese në partitë politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.

(Opsion I)

6. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, Avokati i Popullit organizon procesin e hapur dhe transparent të aplikimit⁸¹ për pozicionin e anëtarit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarit në Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit, si dhe të Komisionerit Publik. Të gjithë kandidatët paraqesin pranë Avokatit të Popullit aplikimet dhe deklaratat e pasurive, në përputhje me parashikimet e ligjit. Brenda katër muajve⁸² nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, Avokati i Popullit harton një listë emërore të aplikuesve duke shënuar për secilin nëse janë plotësuar kriteret përzgjedhëse formale dhe ia dërgon atë Kuvendit.

7. Brenda 30 ditëve nga marrja e listës emërore, Kuvendi me tre të pestat e të gjithë

⁷⁷ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 73 është ndryshuar në vijim të kërkesës së Komisionit të BE-së.

⁷⁸ Opinioni i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias 117-118.

⁷⁹ Disa parashikime do të jenë të ndryshme, si p.sh. ato që lidhen me pagën dhe mbrojtjen.

⁸⁰ Përkufizimi i funksioneve politike në administratën publike është i parashikuar në Ligjin 8095 dt. 21.3. 1996 për Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë, (Neni 15, aneksi 1) dhe Ligji 152/2013 Neni 2.

⁸¹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 60.

⁸² Koha e nevojshmë që ILDKPI-ja të kontrollojë deklaratat e pasurive të kandidatëve.

anëtarëve të tij, emëron anëtarët për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe dy Komisionerët Publikë nga lista e kandidatëve të paraqitur nga Avokati i Popullit duke marrë parasysh rekomandimet e dhëna nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit⁸³. Në rast se Kuvendi nuk arrin të emërojë të gjithë anëtarët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë brenda 30 ditëve, në ditën e tridhjetë e pestë Presidenti i Republikës, nga lista emërore e kandidatëve të rekomanduar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, përzgjedh me short publik anëtarët, gjyqtarët ose komisionerët publikë. Emrat e përzgjedhur konsiderohen automatikisht të emëruar. Ligji rregullon detajet e kësaj procedure.

(Opsioni II)

6. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, Avokati i Popullit organizon procesin e hapur dhe transparent të aplikimit⁸⁴ për pozicionin e anëtarit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarit në Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit, si dhe Komisionerit Publik. Të gjithë kandidatët paraqesin pranë Avokatit të Popullit aplikimet dhe deklaratat e pasurive, sipas ligjit. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, krijohet Komisioni Përzgjedhës. Selia e Komisionit Përzgjedhës është pranë zyrave të Avokatit të Popullit. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues caktuar nga Kryeministri, një përfaqësues caktuar nga Presidenti i Republikës, dhe tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Nëse Kryeministri ose Presidenti nuk caktojnë përfaqësuesit, Komisioni funksionon me anëtarët e tjerë. Brenda dy muajve⁸⁵ nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, Avokati i Popullit harton një listë emërore të aplikuesve duke shënuar për secilin nëse janë plotësuar kriteret përzgjedhëse formale dhe ia dërgon atë Komisionit Përzgjedhës. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, Komisioni Përzgjedhës përzgjedh me shumicë të thjeshtë të anëtarëve, kandidatët nga lista emërore e përpiluar nga Avokati i Popullit, të cilët plotësojnë kriteret dhe konsiderohen të besueshëm dhe të përshtatshëm për zbatimin e rivlerësimit. Nëse ekziston mundësia, propozimi duhet të përmbajë dyfishin e kandidaturave të nevojshme për vendet vakante. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij Aneksi, Këshilli Përzgjedhës përcjell propozimet tek Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Kryeministri. Në rast se propozimi përmban më shumë kandidatë se sa vende vakante, Presidenti i Republikës dhe Kryeministri gëzojnë të drejtën të heqin nga lista emrin e një kandidati. Brenda shtatë ditëve, lista emërore i dërgohet Kuvendit. Në rast se të dy institucionet nuk dërgojnë listën në Kuvend, në ditën e tetë, lista e propozuar nga Këshilli Përzgjedhës konsiderohet përfundimtare.

7. Brenda shtatë ditëve nga marrja e listës emërore, Kuvendi me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të tij, emëron anëtarët për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe dy Komisionerët Publikë nga lista përfundimtare e kandidatëve të propozuar⁸⁶. Në rast se Kuvendi nuk arrin të emërojë të gjithë anëtarët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë brenda këtij afati, Kryetari i

⁸³ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 61, shënimi 16.

⁸⁴ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 60.

⁸⁵ Koha e nevojshme që ILDKPI-ja të kontrollojë deklaratat e pasurive të kandidatëve.

⁸⁶ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 61, shënimi 16

Kuvendit brenda shtatë ditëve përzgjedh me short publik anëtarët, gjyqtarët ose komisionerët publikë nga lista përfundimtare e kandidatëve të propozuar. Në rast se Kryetari i Kuvendit nuk arrin të hedhë shortin, atëherë shorti hidhet nga Drejtuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Emrat e përzgjedhur konsiderohen automatikisht të emëruar. Ligji rregullon detajet e kësaj procedure.

8. Anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe Komisioneri Publik ushtrojnë detyrën me kohë të plotë dhe nuk mund të mbajnë asnjë pozicion apo të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër gjatë kohëzgjatjes së mandatit.

9. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit dhe **Komisionerët Publikë** kanë buxhet, personel dhe mjedise të mjaftueshme për të kryer funksionet e tyre si dhe për të mundësuar ushtrimin e funksioneve të vëzhguesve ndërkombëtarë, sipas ligjit.

10. Gjuhët zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe **Komisionerëve Publikë** janë gjuha shqipe dhe angleze. Të dyja organet punësojnë përkthyes për këtë qëllim.

11. Anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe **Komisioneri Publik** mban përgjegjësi disiplinore. Rastet e shkeljes disiplinore shqyrtohen nga Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit, pa pjesëmarrjen e anëtarëve subjekt procedimi, sipas ligjit. Shkarkimi i tij bëhet vetëm për shkelje të rënda.⁸⁷

12. Anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtari i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit dhe **Komisioneri Publik** gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij.⁸⁸

13. Anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit, komisionerëve publikë, vëzhguesve ndërkombëtarë, punonjësve të administratës dhe familjarëve të tyre u garantohet mbrojtje e nivelit të lartë, sipas ligjit.⁸⁹

Neni Ç **Rivlerësimi**

1. Të gjithë zyrtarët e parashikuar në Nenin **179/b paragrafi 1 i Kushtetutës** rivlerësohen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në shkallë të parë dhe nga Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit në shkallë të dytë. Ata i nënshtrohen një vlerësimi të

⁸⁷ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 128. Ligji zbatues do të përcaktojë se si do të kryhet procedimi disiplinor.

⁸⁸ Parashikuar me qëllim që të sigurohet që gjyqtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit nuk do të jenë objekt i kërcënimeve nga prokuroria për vendimet me shkrim ose deklaratat verbale të dhëna gjatë ushtrimit të detyrës. Si gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, anëtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është i mbrojtur nga norma kushtetuese.

⁸⁹ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 128.

pasurisë, sipas nenit D, një kontrolli të figurës, sipas nenit DH dhe një vlerësimi të aftësive profesionale, sipas nenit E.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit publikojnë vendimet e tyre si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të drejtë.⁹⁰

3. Institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit, duke vënë në dispozicion të tyre informacionin e kërkuar si dhe duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në bazat e tyre të të dhënave. Ata mund të japin mendime ose të bëjnë propozime konkrete, sipas ligjit.

4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit, përmes personelit të tyre, Komisionerëve Publikë, anëtarëve dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, shqyrton deklaratat e të vlerësuarit mbi të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat qeveritare të të dhënave, me kushtin që të mos jenë të klasifikuara si “sekret shtetëror”, duke përfshirë këtu edhe dosjet personale të të vlerësuarit, të dhëna statistikore, dosje të përzgjedhura për vlerësim, vetë vlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat mbi trajnimet dhe ankimet kundër të vlerësuarve, rezultatet e verifikimit të ankesave, vendimet për marrjen e masave disiplinore ndaj të vlerësuarve, të dhënat mbi pronat e të vlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, bazat e të dhënave mbi automjetet, të dhëna për hyrje–daljet në kufi si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit mund të urdhërojë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose japin prova në përputhje me këtë ligj.⁹¹

5. Në zbatim të ligjit, personeli i Komisionit i Pavarur i Kualifikimit dhe i Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit përgatit nga një dosje me raportet, rekomandimet dhe të dhënat mbi pasuritë, figurën dhe vlerësimin e aftësisë profesionale të çdo subjekti të vlerësimit. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit shqyrton çdo dosje të vlerësimit dhe dokumentat e depozituara nga subjekti i vlerësimit, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit merr vendim bazuar në shqyrtimin e njëjës prej dosjeve të vlerësimit sipas paragrafit 1 të këtij Neni ose bazuar në vlerësimin tërësor të të tre komponentëve të vlerësimit dhe informacionit të siguruar. Komisionit i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit gjatë punës së tyre respektojnë parimet e parashikuara në Nenin 179/b të Kushtetutës⁹².

⁹⁰ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 103, 105, shënimi 38-39.

⁹¹ Opinioni Final i Komisionit të Venecias paragrafi 84.

⁹² Rekomandim i Komisionit të BE-së për të përsëritur zbatueshmërinë e këtyre parimeve.

Neni D Vlerësimi i Pasurive

1. Subjektet e vlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe **të personave të lidhur**.
2. Subjekti i vlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport mbi ligjshmërinë e pasurive mbi saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, si dhe mund të rekomandojë vendosjen e masave disiplinore në përputhje me ligjin.
3. **Subjekti vlerësues duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave**⁹³. Pasuri e ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elementë **të detajuar** të pasurisë së ligjshme përcaktohet me ligj.
4. Nëse subjekti i vlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i vlerësimit ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën. **Kalimi i barrës së provës tek subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe, në veçanti, jo për procedime penale të tjera**⁹⁴.
5. Nëse subjekti i vlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë ose përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi ose në posedim të tij ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i vlerësimit ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën. **Kalimi i barrës së provës tek subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe, në veçanti, jo për procedime penale të tjera**.

Neni DH Kontrolli i Figurës

1. Subjektet e vlerësimit dorëzojnë një deklaratë dhe i nënshtrohen një kontrolli të figurës me qëllim identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme⁹⁵ me **persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontrolli i figurës për lidhje me personat e përfshirë në krimin e organizuar bazohet në deklaratën dhe prova të tjera të përshtatshme** duke përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja.⁹⁶
2. Subjektet e vlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar mbi figurën e tyre që mbulon periudhën 1 Janar 2012 **deri në ditën e**

⁹³ Konventa e Palermos e Kombeve të Bashkuara neni 12 pika 7

⁹⁴ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 121.

⁹⁵ Opinion final i Komisionit të Venecias, paragrafi 85.

⁹⁶ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 122.

deklarimit siç parashikohet në ligj. **Deklarata** mund të përdoret **si provë vetëm në këtë procedure** dhe në asnjë rast nuk mund të përdoret në një çështje penale.⁹⁷

3. Nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me **persona të përfshirë në krimin e organizuar** zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i vlerësimit ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën. **Kalimi i barrës së provës tek subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe, në veçanti, jo për procedime penale të tjera.**

4. Nëse subjekti i vlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën mbi figurën, ose përpiket të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehtë kontaktet **me personat e përfshirë në krimin e organizuar**, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i vlerësimit ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën. **Kalimi i barrës së provës tek subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe, në veçanti, jo për procedime penale të tjera.**

Neni E **Vlerësimi i Aftësive Profesionale**

1. Subjektet e vlerësimit i nënshtrohen një vlerësimi të aftësisë profesionale me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer rolin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi që mund të korrigjohen përmes trajnimit.

2. Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e **punonjësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve** në kohën kur kryhet vlerësimi. Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, **këshilltarët ose ndihmësit ligjorë** përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj. Vlerësimi i aftësisë për prokurorët përfshin aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale si dhe cilësitë personale **bazuar në standartet e parashikuara në ligj**. Vlerësimi i aftësisë për këshilltarët **ose ndihmësat ligjorë mund të kërkojë dhënien e një provimi në Shkollën e Magjistraturës**. Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.⁹⁸

3. Nëse rezulton se subjekti i vlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje **të diskutueshme**, ose ka një model të vazhdueshëm **ose thelbësor** pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit. Subjekti i vlerësuar ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën. **Kalimi i barrës së provës tek subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe, në veçanti, jo për procedime penale të tjera.**

4. Nëse rezulton se subjekti i vlerësuar nuk ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të **papërshtatshme**, ose ka një model të vazhdueshëm **ose thelbësor** pune që nuk

⁹⁷ Opinion i Komisionit të Venecias shprehur verbalisht gjatë seancës plenare të dt. 18.12.2015

⁹⁸ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias, paragrafi 107.

pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e konstatuar nuk mund të korrigojë përmes programit të trajnimit një **vjeçar**, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe i vlerësuar ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën. **Kalimi i barrës së provës tek subjekti vlerësues zbatohet vetëm për këtë vlerësim dhe, në veçanti, jo për procedime penale të tjera.**

5. Nëse subjekti i vlerësuar kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model të vazhdueshëm **ose thelbësor** pune aq të dobët sa që rrezikon ose cënon të drejtat e qytetarëve, subjekti i vlerësuar konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti i vlerësuar ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën.

Neni E Vlerësimi në Shkallë të Parë

1. **Një anëtar i trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të jetë relatori.**
2. Relatori mund të kërkojë informacion shtesë dhe **propozon marrjen e një vendimi duke parashtruar arsyetimin.** Subjektit të vlerësimit i jepet një kopje e **raportit propozues dhe masës disiplinore dhe ai** ka të drejtë, brenda një afati të caktuar me ligj, të pranojë ose kundërshtojë propozimin ose të sjellë prova shtesë. **Relatori gëzon të drejtën të kërkojë ndihmë nga autoritetet e huaja dhe mund të ndihmohet nga institucionet shqiptare⁹⁹.**
3. **Trupi gjykues fton subjektin vlerësues në seancë dëgjimore, sipas ligjit.**

Neni F Masat Disiplinore

1. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit **ose Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit** arrijnë në përfundimin se duhet një masë disiplinore mbi subjektin e vlerësuar, trupa përgjegjëse merr një vendim të arsyetuar për dhënien e masës disiplinore të pezullimit nga detyra për një vit të shoqëruar me trajnim të detyrueshëm ose shkarkimin nga detyra.
2. Vendimi i arsyetuar që urdhëron pezullimin nga detyra shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë, dhe e pezullon të vlerësuarin duke i njohur atij të drejtën e një page sa **75%** e pagës së gjyqtarit të rrethit gjyqësor, e cakton subjektin e vlerësuar pranë Shkollës së Magjistraturës deri në fillimin e programit të trajnimit dhe urdhëron ndjekjen e një programi trajnimi një vjeçar dhe një provimi, të përshtatur për eliminimin e mangësive të identifikuara. Në përfundim të programit të trajnimit, subjekti i pezulluar testohet për aftësitë e tij. Ky testim bëhet në mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Subjektet e vlerësuar që nuk e kalojnë testimin shkarkohen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

⁹⁹ Parashikim në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, nëse do të jetë e nevojshme

3. Në çdo rast shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk përbën shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim sipas parashikimeve në kodet procedurale.¹⁰⁰

Neni G Shqyrtimi në Apel

1. Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit përbëhet nga shtatë gjyqtarë. Vetëm gjytarët e emëruar në Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit mund të gjykojnë ankimet kundër vlerësimit të kualifikimit sipas këtij Aneksi. Ata marrin vendime në trupa gjykues të përbërë nga pesë anëtarë secili¹⁰¹. Subjekti i rivlerësuar gëzon të drejtën e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Kualifikimit brendat afatit të parashikuar në ligj. Secili nga Komisionerët Publikë gëzon gjithashtu të drejtën e ankimit në përputhje me ligjin, më përjashtim të vendimeve të marra sipas Nenit F, paragrafi 2, fjalia 4 të këtij ligji. Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit ka kompetencë të ndërmarrë hapa të posaçëm për gjetjen/mbledhjen e fakteve/provave dhe të korigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit merr vendim në lidhje me çështjen dhe nuk mund ta transferojë atë tek Komisioni i Pavarur i Kualifikimit¹⁰². Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit siguron respektimin e të drejtave themelore të subjektit të vlerësuar brenda kufijve të përcaktuara nga Neni A i këtij ligji. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet tek kriteret e përcaktuara në këtë ligj¹⁰³.

2. Vëzhguesi ndërkombëtar në Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit gëzon të njëjtat të drejta si dhe vëzhguesit ndërkombëtarë pranë Komisionit.¹⁰⁴

3. Vendimi i arsytuar që urdhëron shkarkimin nga detyra hyn në fuqi menjëherë, përveç rastit kur ndaj tij ushtrohet ankim. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit subjekti i vlerësimit paguhet në masën 75% të pagës së gjyqtarit të rrethit gjyqësor. Nëse Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit pranon ankimin duke shfuqizuar vendimin e Komisionit, pjesa prej 25 % e pagës i paguhet subjektit të vlerësuar për të gjithë periudhën e ndërprerjes. Vendimi përfundimtar që urdhëron shkarkimin nga detyra hyn në fuqi menjëherë.

4. Subjekti i vlerësuar kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit, pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit.

5. Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon¹⁰⁵ vendimin e Komisionit duke dhënë vendim me shkrim të arsytuar. Në rastet e ankimeve nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit nuk mund të vendosë një masë

¹⁰⁰ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 123.

¹⁰¹ Rekomandim i Komisionit të BE-së.

¹⁰² Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias paragrafi 117.

¹⁰³ Opinion Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 66; përfshin aksesin për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

¹⁰⁴ Opinion i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias, paragrafi 135.

¹⁰⁵ Opinion Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 68.

disiplinore më të rëndë pa i dhënë subjektit të vlerësuar kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për t'u dëgjuar në seancë¹⁰⁶.

6. Subjekti i vlerësuar gëzon të drejtën t'i drejtohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁰⁷.

Neni H¹⁰⁸ **Dorëheqja**

1. Subjekti i vlerësuar mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe procesi i vlerësimit ndërpritet menjëherë.

2. Nëse subjekti i vlerësuar jep dorëheqjen ai përfiton menjëherë nga e drejta e pensionit sipas ligjit në fuqi.¹⁰⁹

3. Subjekti i vlerësuar i cili dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar në asnjë shkallë të gjyqësorit, prokuror, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 10 vjeçare.

¹⁰⁶ Opinioni i Ndërmjetëm i Komisionit të Venecias, paragrafi 106.

¹⁰⁷ Opinioni Final i Komisionit të Venecias 824/2015 paragrafi 57.

¹⁰⁸ Nen i ri për arsye teknike bazuar në rekomandimin e Komisionit të BE-së

¹⁰⁹ Sipas rekomandimit të Komisionit të Venecias (psh. të Komisionit të Venecias paragrafi 101) shumë parashikime janë hequr nga dispozitat kushtetuese dhe janë parashikuar në ligj.